

**KREU PARE**  
**PËRKUFIZIMI – OBJEKTI - SELIA – KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

Është krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me Ortak të Vetëm e quajtur “ARPIO ALBANIA - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me Ortak të Vetëm” me seli në Tiranë, Rruga e Kavajes - pallati nr 126 - shkalla 28 kati 2 - Ap 2

**Neni 2**

Shoqëria ka për objekt të gjitha veprimtaritë e shitblerjes imobiliare, të gjitha punimet e ristrukturimit e të ndërtimit, në fushën e ndërtimit dhe të impianteve për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë e të komunikimit e të telekomunikacionit, në Shqipëri e jashtë saj; Veprimet e blerjes e të shitjes së titujve financiarë, aksione, obligime dhe të tjera.

Shoqëria mund të marrë përsipër përfaqësi në Shqipëri dhe jashtë shtetit, me apo depozitë, të japë apo të marrë menaxhimin e sipërmarrjeve, të marrë o të japë bashkëpunim, kuota, pjesëmarrje të Shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja që kanë objekt të njëjtë të shoqërisë, të ngjashëm, të përafërt, të lidhur ose të ndërlidhur me objektin e saj ose të lidhur indirekt.

Shoqëria mund të kryejë edhe veprime tregtare, industriale, të tundshme e të patundshme të cilësuar të nevojshme ose të duhura për të përmbushur objektivat e shoqërisë, të japë hua garanci si dhe garanci reale ose personale, edhe në favor të të tretëve, dhe të marrë përsipër pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose sipërmarrje, me kusht që këto veprimtari nuk kryhen për publikun as kryesisht, duke iu bazuar ligjeve në fuqi.

**Neni 3** – Shoqëria ka seli ligjore në Tiranë, Rruga e Kavajes - pallati nr 126 - shkalla 28 kati 2 - Ap 2

Ajo mund të hapë e të mbyllë seli dytësore, degë dytësore në Shqipëri dhe jashtë saj, dhe mund të transferojë vendndodhjen e zyrave në lidhje me selinë e shoqërisë dhe/ose të selive dytësore.

**Neni 4** - Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri më 31 Dhjetor 2098 (dy mijë e nëntëdhjetë e tetë) e mund të shtyhet ose edhe paraprakisht të mbyllet me vendosjen e asamblesë së ortakëve.

**KREU II – KAPITALI I SHOQËRISË - ADMINISTRIMI**

**Neni 5** - Kapitali i shoqërisë është 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë Lek) dhe është i ndarë në kuota sipas ligjit, të abonuar nga paraqitja në proporcione të mëposhtme:

Kristina Allko 100%, 1 Kuota, Lek 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë Lek).

**Neni 6** - Eshtë a nominuar Administratore e Shoqërisë Zonja Kristina Allko, lindur ne Cerie Skrapare (ALBANIA), 29-04-1985, nr Pashporte BF9264997, vendbanimi Rruga e Kavajes - pallati nr 126 - shkalla 28 kati 2 - Ap 2.

**Neni 7** – Vendimi për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë mund të lejojë dhënien e cdo elementi ndryshues të vlerës ekonomike, përfshirë këtu punët ose shërbimeve në favor të shoqërisë, duke përcaktuar mënyrat e dhënies së tyre; në mungesë të një përcaktimi ndryshë dhënia duhet të kryhet në para.

Sigurimi ose garancia të parashikuara nga ligji si garanci të detyrimeve të punës ose të shërbimeve mund të zëvendësohen nga ortaku me derdhjen si titull të garancisë të shumës përkatëse pranë shoqërisë.



**Neni 8** - Në rast të zvogëlimit të kapitalit në rast humbje mund të hiqet depozita preventive pranë selisë së shoqërisë të relacionit të organit administrativ rreth situatës së pasurisë së shoqërisë dhe sugjerimeve të organit të mundshëm të kontrollit.

#### KREU II – KAPITALI I SHOQËRISË – FINANCIMI I ORTAKËVE

**Neni 9** - ortakët, me kërkesë të organit administrativ, mund të kryejnë financime pa detyrime rimbursimi ose me detyrime rimbursimi, me detyrime ose falas, duke respektuar kushtet dhe kufinj të përcaktuara nga ligji në fushëm e mbledhjes së kursimeve. Financimet mund të kryhen edhe në mënyrë jo të barazvlefshme të pjesmarrjes së ortakut. Financimet e kryera nga ortakët cilësohen që nuk prodhojnë interesa, ose vetëm nëse nuk cilësohet ndryshe nga ana e organit administrativ në kërkesë.

#### KREU III – PJESËMARRJA NË SHOQËRI

**Neni 10** - Të drejtat e shoqërisë u takojnë ortakëve në masë të proporcionuar me pjesëmarrjen që secilit i takon.

**Neni 11** - Në rast të transferimit të kuotave të shoqërisë ose të një pjese të tyre me akt ndër të gjallë, me detyrime ose falas, u rezervohet ortakëve të tjerë e drejta e përzgjedhjes.

Për këtë qëllim ortakut që mendon të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë të gjithë ortakët përmes një letër rekomandimi me njoftim të marrjes ose me mjet tjetër që vërteton njoftimin., duke përcaktuar emrin e blerësit, shumën dhe të gjitha kushtet e tjetërsimit. Njoftimi vlen si propozim kontrate kundrejt ortakëve, që mund të përcaktojnë përmbylljen e kontratës duke i komunikuar propozuesit pranimin e tyre brenda gjashtëdhjetëditëve nga marrja e propozimit. Heqja dorë nga e drejta e përzgjedhjes, e shprehur ose e menduar në rast të mungesës së përgjigjes në përfundim të gjashtëdhjetëditëve nga marrja e njoftimit, i mundëson ortakut të lëshojë lirisht kuotën e tij ekskluzivisht subjektit dhe me konditat e përcaktuara në njoftim. Megjithatë transferimi do të kryhet brenda tridhjetë ditëve që pasojnë refuzimin e të drejtës së përzgjedhjes.

E drejta e përzgjedhje nuk aplikohet kur ortakut transferon tërësisht ose pjesërisht kuotën e tij në favor të bashkëshort/it/es ose të një të afërmi të drejtpërdrejtë.

#### TËRHEQJA E ORTAKUT – VENDIMET E ORTAKËVE

**Neni 12** – Ortaku mund të tërhiqet nga shoqëria në rastet e parashikuara nga ligji.

Vullneti për t'u tërhequr duhet t'i komunikohet organit administrativ përmes një letre rekomande me njoftim mbërritje, brenda tridhjetë ditëve nga regjistrimi në regjistrin e sipërmarrjeve të vendimit që legjitimon tërheqjen, ose në mungesë të një vendimi, nga momenti kur ortakut njihet me faktin që e legjitimon. Ushtrimi i të drejtës së tërheqjes duhet t'i komunikohet QKB-së nga organi administrativ. Kuotat për të cilat ushtrohet e drejta e tërheqjes nuk mund të jepen. Tërheqja nuk mund të ushtrohet, e nëse është ushtruar nuk ka vlerë, kur shoqëria revokon të drejtën që e legjitimon.

**Neni 13** – Ortaku që tërhiqet nga shoqëria ka të drejtën e rimbursimit të kuotës së tij në proporcion me vlerën e shoqërisë, të përcaktuar duke marrë parasysh situatën e pasurisë së shoqërisë, të fitimeve, të vlerave të miravemateriale dhe jomateriale që ajo posedon, të pozitës së saj në treg dhe të cdo rrethane tjetër e kushti që zakonisht merret parasysh me qëllim përcaktimin e vlerës së tregut të kuotave të shoqërisë; në rast mosmarrveshje përcaktimi kryhet



në bazë të një relacioni zyrtar i kryer nga një ekspert i emëruar nga gjykata sipas ligjit, me kërkesë të palës më përgjegjëse.

Rimbursimi duhet të kryhet me mënyrat e parashikuara nga ligji, brenda njëqind e tetëdhjetëditëve nga komunikimi i vullnetit për t'u tërhequr.

**Neni 14** – Ortakët vendosin rreth çështjeve kompetencë e tyre të përcaktuara nga ligji ose nga rregullat aktuale të funksionimit të shoqërisë, e rreth çështjeve që duhet të aprovohen nga ata nga një ose më shumë administratorë ose nga shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë.

Vendimet e ortakëve të marra në përputhje me ligjin ose me aktin themelues detyrojnë të gjithë ortakët, edhe pse në mungesë ose që nuk janë dakort.

**Neni 15** – Janë kompetenca të ortakëve:

- 1) Aprovimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimeve;
- 2) Emërimi dhe revokimi i administratorëve, përvec të drejtave në lidhje me administrimin e shoqërisë që mund t'u jenë dhënë një ortaku të vetëm;
- 3) Emërimi i mundshëm i kryetarëve dhe të presidentit të dhomës së kryetarëve ose të kontrollorit;
- 4) Ndryshimet e aktit themelues;
- 5) Vendosja për kryerjen e veprimeve që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë ose të një ndryshimi të rëndësishëm të të drejtave të ortakëve;
- 6) Emërimi dhe revokimi i likuiduesve dhe kriteret e kryerjes së likuidimit;
- 7) Vendimet e tjera që ligji rezervon në mënyrë të patjetërsueshme si kompetencë e ortakëve.

**Neni 16** – Vendimet e ortakëve merrën me votën në favor të ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë e mund të zbatohen me vendim asambleje, përmes një konsultimi të shkruar ose mbi bazën e konsensusit të shprehur me shkrim nga ortakët.

Cdo ortak që nuk ka detyrime në ushtrimin e të drejtave ka të drejtën të marrë pjesë në vendime, dhe vota e tij vlen në mënyrë të proporcinuar me pjesëmarrjen e tij.

Duhet marre gjithmone përmes vendimeve të asamblesë vendimet e ortakëve që lidhen me ndryshimet e aktit themelues ose kryerjen e veprimeve që sjellin një ndryshim esencial të objektit të shoqërisë të përcaktuar në aktin themelues ose një ndryshim të rëndësishëm të të drejtave të ortakëve, por edhe kur e kërkon një ose më shumë administrator ose ortakët që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë, ose që është e parashikuar shprehimisht nga ligji.

**Neni 17** Procedimi për konsultimin e shkruar ose marrjen e konsensusit të shprehur me shkrim rregullohet si më poshtë.

Një nga ortakët ose një nga administratorët i komunikon të gjithë ortakëve dhe të gjithë administratorëve jo ortakë tekstin e vendimit që do të merret, duke përcaktuar një afat jo më pak se tetë ditë Brenda të cilit cdo ortak duhet të dojë në selinë e shoqërisë konsensusin e mundshëm. Në rast të mungesës së përgjigjes brenda afatit të përcaktuar, konsensusi cilësohet i munguar. Tek dokumentat duhet të rezultojnë të qarta çështja objekt i vendimit dhe konsensusi i saj.

Njoftimet mund të bëhen me cdo mjet që lejon verifikimin e prejardhjes dhe që të mundësohet përgjigjia e marrjes (edhe përmes deklaratës së marrjes të dërguar me të njëjtin mjet), përfshirë telefaksin dhe postën elektronike, dhe duhet të ruhen nga shoqëria.

Vendimet e ortakëve të marra në këtë mënyrë duhet të figurojnë në procesverbalin e posacëm të përpiluar nga organi administrativ dhe të shënuar në librin e vendimeve të ortakëve.

#### KREU IV – ASAMBLEJA



**Neni 18 - Asambleja e ortakëve rregullohet nga normat e mëposhtme:**

- a) Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së shoqërisë, me kusht që të jetë në territorin e Shtetit;
- b) Asambleja thirret nga organi administrativ me një njoftim që përmban ditën, vendin, orën e takimit dhe listën e çështjeve që do trajtohen, të dërguar cdo ortaku të paktën tetë ditë përpara asaj të përcaktuar për asamblenë; njoftimi duhet të dërgohet përmes një letre rekomande me kthim përgjigje të dërguar në adresën që rezulton në QKB, ose me cdo mjet tjetër që mundëson përgjigjen (edhe përmes një deklaratë marrje të dërguar me të njëjtin mjet), përfshirë telefaksin dhe postën elektronike, në adresën të përcaktuar paraprakisht nga ortaku dhe të shënuar në librin e vendimeve; në rast të pamundësisë apo të mosfunksionimit të organit administrativ asambleja mund të thirret nga organi i mundshëm i kontrollit ose nga një nga ortakët; në njoftimin e thirrjes mund të parashikohet një datë e mëtejshme si thirrje e dytë; për rastin kur në mbledhjen e parashikuar në thirrjen e parë asambleja nuk rezulton e mbledhur ligjerisht, por edhe në thirrjen e dytë aplikohen shumicat e parashikuara për thirrjen e parë;
- c) Në cdo rast asambleja cilësohet rregullisht e mbledhur kur është prezen i gjithë kapitali i shoqërisë, janë prezent ose rezultojnë që janë njoftuar për mbledhjen të gjithë administratorët dhe përbërësit e organit të mundshëm të kontrollit, asnjë nuk kundërshton për trajtimin e çështjes;
- d) Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga një person tjetër përmes një autorizimi të shkruar që duhet të ruhet nga shoqëria;
- e) Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e mbledhjes, vërteton identitetin dhe legjitimitetin e te pranishmëve, rregullon zhvillimin e saj, vërteton dhe njofton rezultatet e votimit; për përfundimet e këtyre verifikimeve duhet të merren shënime në procesverbal;
- f) Asambleja drejtohet nga administratori unik ose nga presidenti i këshillit të administrimit, dhe në mungesë, nga personi i zgjedhur nga pjesëmarrësit që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë të pranishëm në asamble;
- g) Asambleja emëron një sekretar, që mund të mos jetë ortak, që përpilon procesverbalin, të nënshkruar nga po ai dhe nga presidenti; në rastet e parashikuara nga ligji dhe kur presidenti e mendon të nevojshme procesverbali mund të redaktohet edhe nga një noter të zgjedhur nga ai;
- h) Asambleja e ortakëve mund të zhvillohet edhe në më shumë vende, të lidhur me audiokonferencë e videokonferencë, e për këtë sipas kushteve të mëposhtme, të cilat duhet të referohen në procesverbal:
  - Që janë prezent në të njëjtin vend presidenti dhe sekretari i mbledhjes që merren me përpilimin dhe nënshkrimin e procesverbalit;
  - Që t'i mundësohet presidentit të asamblesë të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin të pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
  - Që t'i mundësohet personit që përpilon procesverbalin të kuptojë sic duhet ngjarjet e asamblesë objekt i procesverbalit;
  - Që t'i mundësohet të pranishëmve të marrin pjesë në diskutime dhe në votimin simultan rreth çështjeve në rend të ditës, por edhe të shohin, të marrin ose të japin dokumenta;



- Që të citohen në njoftimin e thirrjes nga ana e shoqërisë (përves rastit kur është asamble totalitare) vendet që do të lidhen me audiokonferencë ose videokonferencë, në të cilët pjesëmarrësit mund të paraqiten për të marrë pjesë në asamble, e mbledhja të zhvillohet në vendin ku është prezent presidenti dhe sekretari.

#### KREU V – ADMINISTRIMI

**Neni 19** . Shoqëria është e administruar në mënyrë alternative:

- a) nga një administrator i vetem;
- b) nga një osë më shumë administratorë.

Lloji i administrimit dhe numri i administratorëve përcaktohen nga ortakët njëkohësisht me emërimin e administratorëve.

Ortakët në momentin e emërimit të organit administrativ ose me vendimmarrje të mëtijshme, mund t'u besojnë administratorëve të drejta administrimi që mund të ushtrojnë bashkarisht ose vecmas, e përcaktuar kompetenca e organit administrative të administrimit për redaktimin e projektit të bilancit dhe në mundësi të tjera të parashikuara nga ligji në mënyrë taksative.

Administratorët mund edhe të mos jenë ortakë dhe janë të rizgjedhshëm.

Organi administrativ qëndron në detyrë deri në revokimin e tij ose deri në dorëheqje ose për kohëzgjatjen e përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit. Administratorët janë të revokueshëm në çdo kohë me vendim të ortakëve, përvec të drejtës së dëmshpërmbimit të drejtës nëse revokimi i administratorit të emëruar më kohë të kufizuar behët pa arsye të drejtë.

Ndërprerja e aktivitetit të administratorit për shkak të përfundimit të afatit ose dorëheqje behët efektive nga momenti kur organi administrative është mbledhur. Në çdo rast administratorët e mbetur në detyrë, ata që e kanë ndërprerë dhe organi i mundshëm i kontrollit duhet të bëjnë që ortakët të marrin vendim për rimbledhjen e organit të administrimit sa më shpejt pra brenda tridhjetë ditëve.

Administratorët nuk mund të marrin cilësinë e ortakëve me përgjegjësi palimite në shoqëri konkurente, as të ushtrojnë një veprimtari konkurrence për llogari të të tretëve, as të jenë administrator ose drejtorë të përgjithshëm në shoqëri konkurente, ose vetëm në rastet kur janë të autorizuar nga ortakët. Për mosndjekjen e këtij ndalimi administratori mund të shkarkohet nga detyra dhe përgjigjet për dëmet.

**Neni 20** - Organi administrativ ka të drejta të plota për administrimin e zakonshëm e të jashtëzakonshëm dhe ka të drejtën të kryejë të gjitha aktet që i cilëson të nevojshëm për implementimin dhe arritjen e objektivave të shoqërisë, përvec atyre që ligji u rezervon në mënyrë taksative ortakëve.

Organi administrativ mund të emërojë përfaqësues për veprime të përcaktuara ose kategori veprimesh dhe të emërojë drejtorë dhe të përgjithshëm.

**Neni 21** - Administratorët janë përfaqësues të përgjithshëm të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim, me mënyrat e mëposhtme.

Kur shoqëria është e administruar nga më shumë administrator përfaqësia e shoqërisë për ushtrimin e vendimeve të këshillit i takon të gjithë administratorëve në mënyrë të ndarë nga njëri tjetri, por nëse u janë dhënë të drejta administrimi më shumë se një administrator që ushtrojnë bashkarisht ose vecmas edhe përfaqësinë, në lidhje me ushtrimin e këtyre të drejtave, nënkuptohet që u jepet atyre më të njëjtat mënyra.

Përfaqësia e shoqërisë u përket edhe drejtorëve, menaxhuesve dhe përfaqësuesve në kufinj të të drejtave të përcaktuara nga organi administrative në momentin e emërimit.



**Neni 22** - Administratorëve u takon rimbursimi i shpenzimeve të kryera për shkak të detyrës, përveç kësaj ortakët mund t'u caktojnë atyre një kompensim vjetor, në masë fisike ose të proporcionuar me fitimet e aktivitetit, e t'u njihet një shpërblim në fuind të mandatit, që është vecmas në një zë të posacëm të gjendjes së pasurisë.

#### KREU VI – BILANCI DHE FITIMET

**Neni 23** - Bilancet mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Oragani i Administrimit do të veprojë me hartimin e bilancit dhe ua paraqet ortakëve për aprovim brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e bilancit. Bilanci mund të paraqitet ortakëve për aprovim brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve, në rast kur me gjykim e organit administrativ, kerkohet nga nevoja të vecanta në lidhje me strukturën dhe objektin e shoqërisë.

**Neni 24** – Nga fitimet neto gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë duhet të lihet mënjane një shumë që korrespondon me të paktën një të njëzetën e tyre si rezervaë ligjore, deri sa kjo shumë të ketë arritur një të pestën e kapitalit të shoqërisë. Pjesa tjetër e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit u shpërndahet ortakëve, përveç rastit kur ata marrin një vendim tjetër.

#### KREU VII – TITUJ DEBIE

**Neni 25** – Shoqëria mund të lëshojë tituj debie, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, pas një vendimi të marrë nga ortakët me votën në favor të ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

#### KREU VIII – RIFERIMI I LIGJIT

**Neni 26** Për sa nuk është parashikuar shprehimisht aplikohen normat sipas ligjit.

**Kristina Allko**

